**UDHËZIM**
**Nr.7, datë 7.5.2007**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË SHPRONËSIMEVE**

*(ndryshuar me udhëzimin nr. 33, datë 2.12.2022)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 8 të ligjit nr.9601, datë 28.7.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006"" për përdorimin e fondit të shpronësimeve

UDHËZOJ:

*1. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin nëpërmjet Ministrisë së infrastrukturës dhe Energjisë paraqet në strukturën përgjegjëse për Thesarin në qendër, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kërkesën për shpronësim, e cila duhet të ketë bashkëngjitur vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësimin e kërkuar.*

2. Ministria e Financave e miraton kërkesën në rast se shpronësimi bëhet për projekte të programeve prioritare të Qeverisë dhe nëse fondet, në llogarinë "Fondi i shpronësimeve" pranë Bankës së Shqipërisë, janë të mjaftueshme.

*3. Pagesa e të shpronësuarve të bëhet si vijon:*

*- Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave, për çdo pronar privat apo subjekt të shpronësuar krijon dosjen përkatëse, në përputhje me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar.*

*- Me përfundimin e kompletimit ligjor të dosjes, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin harton listëpagesën për dosjet e përfunduara (sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi).*

*- Listëpagesa e miratuar zyrtarisht nga titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, i bashkëngjitet kërkesës zyrtare dhe paraqitet për pagesë nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë pranë ministrit përgjegjës për financat.*

4. Ministri i Financave, bazuar në listëpagesën bashkëngjitur kërkesës, lëshon urdhërpagesën për Bankën e Shqipërisë, e cila kryen transfertat në llogaritë personale bankare të të shpronësuarve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**

## LISTEPAGESE PER SHPRONESIMET

| Nr | Emri Atesia Mbiemri | V. K. M. | | Objekti i Shpronesimit | Vlera | Rrethi | Bashki/ Komune | Referencat bankare | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr | Date | | | | | Adresa | Nr.llogarise |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |

**Personat e autorizuar per plotesim dosje dhe likujdim**

| Nr | Emri Mbiemri | Detyra funksionale | Firma |
|---|---|---|---|
| 1 | | | |
| 2 | | | |
| 3 | | | |
| 4 | | | |
| 5 | | | |

MIRATOHET

Titullari Vula